



This project is financed by
the EUROPEAN UNION

"MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE" KATALOGU I TRAJNIMEVE



KATALOGU I TRAJNIMEVE
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE



WWW.ASPA.GOV.AL

facebook: ASPA - Shkolla Shqiptare e Administrates Publike
e-mail: aspa@aspa.gov.al website: www.aspa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRI PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATEN PUBLIKE



"HUMAN RESOURCES MANAGEMENT" TRAINING CATALOG



ASPA TRAINING CATALOGUE



WWW.ASPA.GOV.AL

facebook: ASPA - Shkolla Shqiptare e Administrates Publike
e-mail: aspa@aspa.gov.al website: www.aspa.gov.al



This project is financed by
the EUROPEAN UNION



“MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE” KATALOGU I TRAJNIMEVE

SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

TIRANË, SHQIPËRI

“Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autoriteteve zbatuese dhe në asnjë rast nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”



Autorët e këtij katalogu janë nëpunës civilë nga administratat publike franceze dhe portugeze, të cilët morën pjesë si ekspertë në projektin evropian të binjakëzimit Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri, të zbatuar nga Shkolla Kombëtare Franceze e Administratës Publike (ENA), Shkolla Kombëtare Italiane e Administratës Publike (SNA) dhe Departamenti i Administratës Publike (DAP):

- **Z. Eric Roty**

Me kontributin e:

- Z. Michel Carles
- Z. Jean-Michel Eymeri Douzans
- Z. Miguel Nuno Rodrigues

Prodhimi i këtij katalogu është financuar nga Bashkimi Evropian përmes projektit të binjakëzimit "Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri".

Informacionet mbi Bashkimin Evropian mund të gjenden në faqen: <http://ec.europa.eu>

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE nga Drejtori i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike	6
Lista e shkurtimeve	8
Hyrje	10
Përshkrim i përgjithshëm i modulit të trajnimit Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	11
Metodologjia e trajnimit	11
Organizimi i Modulit të Trajnimit	11
Publiku i synuar	13
Nën-moduli 1: Legjislacioni i shërbimit civil	14
1.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit	14
1.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve	14
1.3 Profili i trajnerëve	14
1.4 Përmbajtja e detajuar e sesioneve të nën-modulit	14
1.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar	15
Nën- Moduli 2: Vlerat, Etika dhe Disiplina	15
2.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit	16
2.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve	16
2.3 Profili i trajnerëve	16
2.4 Përmbajtja e detajuar e sesioneve të nën-modulit	16
2.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar	17
Nën- Moduli 3: Analiza dhe përshkrimi i vendit të punës; rekrutimi	17
3.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit	18
3.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve	18
3.3 Profili i trajnerëve	18
3.4 Përmbajtja e detajuar e sesioneve të nën-modulit	18
3.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar	20
Nën- Moduli 4: Menaxhimi i personelit / performancës individuale	22
4.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit	22
4.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve	22

4.3 Profili i trajnerëve	23
4.4 Përbajtja e detajuar e sesioneve të nën-modulit	23
4.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar	24
Nën- Moduli 5: Trajnimi dhe zhvillimi profesional	26
5.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit	26
5.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve	26
5.3 Profili i trajnerëve	26
5.4 Përbajtja e detajuar e sesioneve të nën-modulit	26
5.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar	27
Nën- Moduli 6: Hartimi i politikave dhe strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore	29
Shënime paraprake në lidhje me këtë modul	29
6.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit	29
6.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve	29
6.3 Profili i trajnerëve	30
6.4 Përbajtja e detajuar e sesioneve të nën-modulit	30
6.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar	30
Shtojcat	32
Shtojca 1: Tabela e përputhshmërisë ndërmjet neneve të Ligjit të Shërbimit Civil dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave - shembull	32
Shtojca 2: Integriteti dhe sjellja etike - raste studimore	37
Shtojca 3: Modeli kompetencave për Drejtuesit e nivelit të lartë	40
Shtojca 4: Kuadri i bazuar në kompetenca - modeli polak	58
Shtojca 5: Detaje praktike për trajnerët dhe drejtuesit e trajnimit në ASPA	60

PARATHËNIE NGA DREJTORI I SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Më 24 qershor 2014, Këshilli Evropian ra dakort, bazuar në rekomandimin e Komisionit Evropian - për t'i dhënë Shqipërisë statusin e kandidatit të BE . Megjithatë, procesi i integritit të Shqipërisë në BE qartazi varet nga reformat e ndërmarra në Shërbimin Civil. Forcimi i kapacitetit të përgjithshëm administrativ të Shqipërisë, nëpërmjet modernizimit të administratës publike shqiptare dhe forcimit të institucioneve kyçe, është prioritet parësor për qeverinë shqiptare dhe për BE-në në procesin e saj të zgjerimit.

Ligji i ri i Shërbimit Civil nr. 152/2013 (i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014) krijon, sipas nenit 8, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP) - e cila zëvendëson Institutin e Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) krijuar me Ligjin e mëparshëm të Shërbimit Civil të vitit 1999.

ASP ka autonomi administrative dhe akademike. Qëllimi i saj është trajnimi profesional i nëpunësve civilë. Për përcaktimin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe të politikave të saj të trajnimit profesional, ASPA bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike (DAP), i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikës shtetërore të Shërbimit Civil.

ASP siguron kurse njohjeje për nëpunësit civilë të sapo rekrutuar dhe programe të vazhdueshme trajnimi profesional për nëpunësit civilë, si dhe për individët jashtë shërbimit.

Ky katalog është përgatitur për të bërë të njohur modulin e trajnimit "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore", pjesë e planit të përgjithshëm të trajnimit të ASPA-s.

Ky modul është ndarë në 7 nën-module: Hartimi i politikave dhe strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore; Legjisllacioni i shërbimit civil; Vlerat, etika dhe disiplina; Menaxhimi i personelit / performancës individuale; Rekrutimi; Përshkrimi dhe analiza e vendit të punës; Trajnimi dhe zhvillimi profesional; Sistemi i regjistrimit të personelit. Nën-moduli i fundit do të zbatohet përmes një metode të bazuar në rrjet dhe nuk përfshihet në këtë përshkrim.

Për të ndjekur ngushtësisht politikën e zbatuar nga qeveria shqiptare në kuadrin procesit të anëtarësimit në BE dhe sipas nevojave të trajnuarve mund të organizohen sesione trajnimi shtesë.

Nëse do të kërkohet, disa sesione trajnimi shtesë mund të organizohen në gjuhë të huaj. Vizitat studimore në Shtetet Anëtare ose vende kandidatë për anëtarësim në BE mund të jenë shtesa të dobishme në programin e trajnimit të TND. Për këtë qëllim mund të përdoret instrumenti TAIEX i BE-së. Nëse do të jetë e mundur, disa module mund të mbahen jashtë Tiranës.

Çështjet ndërsektoriale si gjinia dhe mjedisi do të trajtohen sa herë që të jetë e nevojshme në modulet e ndryshme të trajnimit.

ASP është anëtare e ReSPA - shkurtim i Shkollës Rajonale të Administratës Publike, një rrjet shkollash të administratës publike që synon të mbështesë krijimin e sistemeve të përgjegjshme, efektive dhe profesionale të administratës publike për Ballkanin Perëndimor,

¹ http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-14-439_en.htm

² <http://www.respaweb.eu/>

në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE. ReSPA organizon dhe ofron aktivitete trajnuese, konferenca të nivelit të lartë, takime për rritjen e rrjetit të njohjeve profesionale dhe botime për të transferuar njohuritë dhe aftësitë e reja, si dhe për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave si brenda rajoni tashtu edhe midis rajonit dhe shteteve anëtare të BE-së.

Siç e përmbledh Strategjia Ndërsektoriale e Reformës së Administratës Publike (SNRAP) 2015 - 2020:

" Në vitin 2013, SIGMA publikoi një dokument, i cili identifikon si prioritete të reformës për administratën publike në Shqipëri deri në vitin 2020 pikat si vijon: zhvillimi i kapaciteteve për hartimin politikave dhe legjisllacionit në mënyrë që të hartohen dhe zbatohen politika efektive dhe në përputhje me "acquis communautaire"; institucione eficientë dhe efikase; shërbim civil profesional që siguron ligjshmërinë dhe parashikueshmërinë e administratës, pavarësinë dhe paanësinë e akteve, që ndihmon në harmonizimin e legjisllacionit me acquis dhe zbatimin e tij; krijimi i strukturave adekuata për zbatimin e procedurave administrative dhe i strukturave të përshtatshme që sigurojnë përgjegjshmërinë administrative dhe politike të administratës."

Ky katalog ka ambicjen të kontribuojë në arritjen e objektivave të lartpërmendura të strategjisë së RAP-it duke u ofruar nëpunësve civilë shqiptarë një mundësi për të forcuar kapacitetin e tyre menaxhues të burimeve njerëzore. Për të arritur këtë qëllim, ASPA do të mbështetet në përvojën akademike dhe profesionale të trajnerëve më të mirë të saj dhe mund të organizojë trajnime të trajnerëve për të siguruar punën më të mirë në ekip si dhe shkëmbimin e praktikave të mira dhe rasteve

studimore nëpër ekipet e trajnerëve.

U urojmë nëpunësve civilë një kurs të frytshëm dhe duam t'i falenderojmë për pjesëmarrjen në këtë aventurë të rëndësishme për modernizimin e vendit tonë.

Fatmir Demneri,
Drejtor i ASPA

³ Ky dokument mund të gjendet në: http://www.sigmaweb.org/publications/Albania_Priorities_2013.pdf

⁴ http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/PAR_Strategy_2015-2020_English.pdf

Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Titulli i plotë
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
LSHC	Ligji për Shërbimin Civil
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DAP	Departamenti i Administratës Publike
PEF	Politika Evropiane e Fqinjësisë
IPEF	Instrumenti i Politikës Evropiane të Fqinjësisë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
FEZhr	Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal
FSE	Fondi Social Evropian
BE	Bashkimi Evropian
GjED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë

Shkurtimi	Titulli i plotë
BNj	Burimet Njerëzore
MBNj	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
AB	Auditi i Brendshëm
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit
IPA	Instrumenti Para-Anëtarësim
IT	Teknologjia e Informacionit
PVP	Përshkrimi i Vendit të Punës
PDP	Pyetje me Disa Përgjigje
ShA	Shtet Anëtar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm

Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Titulli i plotë	Shkurtimi	Titulli i plotë
MRP	Menaxhimi i Ri Publik	EA	Ekspert Afatshkurtër
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020	SWOT	Pikat e Forta, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet
LOB	Ligji Organik i Buxhetit	TAIEX	Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik	PVT	Plani Veprimit për Trajnimet
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
RAP	Reforma në Administratën Publike	VNT	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
FP	Financat Publike	TND	Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues
MFP	Menaxhimi i Financave Publike	TiT	Trajnimi i Trajnerëve
PPT	PowerPoint	OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PRAG	Udhëzues Praktik për Procedurat Kontraktuale për Veprimin e Jashtëm të BE-së	UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit	UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
SIGMA	Mbështetje në Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit	OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

HYRJE

Qëllimi i këtij katalogu trajnimi është të japë një përshkrim të qartë dhe gjithëpërfshirës të modulit të trajnimit mbi "Menaxhimin e Burimeve Njerëzore" të propozuar nga ASPA për kategori të ndryshme të nëpunësve civilë: specialistë të burimeve njerëzore, anëtarë në komisionet e përzgjedhjes, drejtues të nivelit të ulët dhe të mesëm, si dhe për drejtues të nivelit të lartë.

Në të njëjtën kohë, struktura e modulit të trajnimit do të krijojë mbështetje për trajnerët e ardhshëm të përzgjedhur nga ASPA në mënyrë që të ketë një qasje të harmonizuar dhe fleksibilitetin për të zellë metoda dhe materiale të reja trajnimi.

Moduli i trajnimit "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore", siç paraqitet më poshtë, mund të përfshihet nga ASPA në planin vjetor të trajnimit si një paketë e plotë ose, në bazë të nevojave të trajnimit, mund të zgjidhet të ofrohen vetëm nën-modulet e kërkuara.

Përveç materialeve të përfshira në këtë katalog, ne rekomandojmë fuqimisht përdorimin e Manualit të Burimeve Njerëzore të hartuar gjithashtu me mbështetjen e ekipit të projektit të Binjakëzimit dhe të shpërndarë në mënyrë elektronike dhe në version shtypi në ministrinë e linjës.

Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij publikimi dhe për çdo gabim i takon autorëve. Ne jemi të vetëdijshëm për pamundësinë e mbulimit të të gjitha aspekteve të nevojshme të menaxhimit të burimeve njerëzore në një dokument të vetëm, të përgatitur në një periudhë të shkurtër

kohore. Sidoqoftë, ne shpresojmë se ky katalog do të ndihmojë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të specialistëve të administratës publike që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe do t'i nxisë ata që të kërkojnë informacione, metodologji dhe qasje të mëtejshme në këtë fushë.

Këtë katalog trajnimi e përgatitëm me ndihmën e kolegëve të DAP, me ndihmën e drejtuesve të trajnimit në ASPA dhe të kolegëve nga ministrinë e linjës, që morën pjesë në seminarët përgatitore dhe në diskutimet dhe që kontribuan me ekspertizën e tyre.

Ekipi i projektit të Binjakëzimit

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I MODULIT TË TRAJNIMIT MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Kursi do të përmbajë 7 nën-modulet e mëposhtme:

1. Hartimi i politikave dhe strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore
2. Legjisllacioni i shërbimit civil
3. Vlerat, etika dhe disiplina
4. Menaxhimi i personelit / performancës individuale
5. Rekrutimi, përshkrimi dhe analiza e vendit të punës
6. Trajnimi dhe zhvillimi profesional
7. Sistemi i regjistrimit të personelit

Sidoqoftë, tema e fundit duhet të zbatohet nëpërmjet një metode të bazuar në internet, e cila mbetet për t'u përcaktuar dhe nuk mbulohet nga ky përshkrim.

Kohëzgjatja e përgjithshme e modulit është 15 ditë pune dhe duhet të shtrihet në një periudhë nga 2 deri në tre muaj.

Kursi do të përfundojë me një sesion vlerësimi dhe gradimi përfundimtar dhe do të kurorëzohet me një certifikatë që i dorëzohet pjesëmarrësve të suksesshëm.

Metodologjia e trajnimit

Baza e metodologjisë së propozuar të trajnimit përbëhet nga dy ide:

- Së pari, të ndërtohet një modul i integruar dhe jo vetëm një koleksion kursesh me tema të ndryshme, komplet pa lidhje me njëri-tjetrin: moduli duhet të pasqyrojë unitetin e brendshëm të MBNJ, ku të gjitha elementet të jenë të ndërlidhura dhe të krijojnë një progres pedagogjik, ku modulet e mëvonshme mund të ndërtohen mbi ato të mëparshmet.
- Së dyti, të mbështetet sa më shumë që të jetë e mundur në praktikë dhe në mësimin me veprim, duke mbajtur teorinë në minimumin e nevojshëm për kuptimin dhe përfundimin e detyrave praktike: koha e përkushtuar ndaj teorisë dhe praktikës (në formën e rasteve studimore dhe ushtrimeve nga jeta reale) janë të barabarta gjatë kohëzgjatjes së modulit.

Duhet të theksohet se integrimi i nën-moduleve në një progres të strukturuar nënkupton që trajnerët duhet të jenë në gjendje të përgatisin sesionin së bashku dhe gjatë rrugës të lënë kohë për bashkërendim.

Gjithashtu mund të theksohet se, edhe pse i gjithë moduli i trajnimit të MBNJ ofron një cikël të plotë me një progres logjik, secili nën-modul është gjithashtu një njësi e pavarur që mund të lëvrohet në mënyrë të

pavarur, nëse është e nevojshme, për të përmbushur nevojat specifike të Ministrive dhe Institucioneve.

Për arsye praktike dhe pedagogjike, ka qenë e nevojshme të riorganizohet renditja e nën-moduleve.

Nën-moduli "Hartimi i politikave dhe strategjive të MBNJ" do të përbëhet në thelb nga studime të rasteve nga jeta reale, të kryera nga grupe të trajnuarish nëpunës të institucioneve aktuale të administratës publike. Për këtë arsye, nën-moduli do të ndahet në dy pjesë, me gjysmën e parë të ditës, fillimi i modulit të trajnimit do t'i kushtohet përgatitjes së studimit, metodës së punës dhe sfondit teorik për pjesëmarrësit.

Pas kësaj, propozohet të fillohet me Legjislacionin e Shërbimit Civil, i cili duhet të jetë themeli mbi të cilin mund të ndërtohen nën-module të tjera.

Kurrikula do të pasojë me këtë renditje: "Vlerat, etika dhe disiplina", "Përshkrimet e vendit të punës dhe rekrutimi", "Menaxhimi i personelit dhe vlerësimi i performancës", "Trajnimi dhe zhvillimi profesional". Kjo duket renditje më logjike, sepse duhet të kesh një njohuri të mira për përshkrimin të vendit të punës për të kryer rekrutimin dhe vlerësimin e performancës dhe sepse informacioni i mbledhur gjatë vlerësimit të performancës është burim kryesor për të vlerësuar saktë nevojat për trajnim.

Pjesa e dytë e nën-modulit "Hartimi i politikave dhe strategjive të MBNJ" do të zhvillohet në fund të të gjithë modulit, për prezantimin dhe diskutimin e studimeve strategjike. Kjo pjesë është mbajtur për në fund, si pika kulmore e modulit, ku pjesëmarrësit do të dorëzojnë rezultatin e një pune që ka qënë në zhvillim gjatë gjithë kohëzgjatjes së trajnimit

dhe do t'u ofrojë të trajnuarve mundësinë e përdorimit praktik të njohurive të fituara në kuadrin e nën-moduleve të tjera.

Moduli do të organizohet siç tregohet në tabelën më poshtë.

Organizimi i Modulit të Trajnimit

NËN-MODULET		Dita 1		Dita 2	
		PARADITE	PASDITE	PARADITE	PASDITE
Nën-moduli 6	Hartimi i Politikave dhe strategjive të MBNJ (pjesa 1)	PËRGATITJE	TEORI	TEORI	-
Nën-moduli 1	Legjisllacioni i Shërbimit Civil	TEORI	USHTRIME NË GRUP	USHTRIME NË GRUP	PËRMBLEDHJE
Nën-moduli 2	Vlerat, etika dhe disiplina	TEORI DHE RASTE STUDIMORE	TEORI DHE RASTE STUDIMORE	USHTRIME NË GRUP	TESTIM INDIVIDUAL DHE PËRMBLEDHJE
Nën-moduli 3.1	Analiza dhe përshkrimi i vendit të punës	TEORI	USHTRIME NË GRUP	TEORI	USHTRIME NË GRUP
Nën-moduli 3.2	Rekrutimi	TEORI	USHTRIME NË GRUP	TEORI	USHTRIME NË GRUP
Nën-moduli 4	Menaxhimi i personelit, vlerësimi i performancës	TEORI	TEORI	USHTRIME NË GRUP	PËRMBLEDHJE
Nën-moduli 5	Trajnimi dhe zhvillimi profesional	TEORI	TEORI	USHTRIME NË GRUP	PËRMBLEDHJE
Nën-moduli 6	Hartimi i Politikave dhe strategjive të MBNJ (pjesa 2)	USHTRIME NË GRUP	USHTRIME NË GRUP	PËRMBLEDHJE	-

Publiku i synuar

Moduli i drejtohet një publiku që tashmë i njih mirë çështjet e burimeve njerëzore. Nëse është e mundur, rekomandohet që të kryhet një testim para fillimit të çdo moduli, në mënyrë që të vlerësohet niveli i vërtetë i njohurive të pjesëmarrësve në çështjet e burimeve njerëzore dhe të merret parasysh ky element në ndarjen e grupeve.

Kursi do t'i jepet me përparësi dy grupeve kryesore:

- Profesionistëve të BNJ që punojnë në Njësitë e Burimeve Njerëzore për të zbatuar politikat dhe procedurat e BNJ, nga niveli i specialistit e lart;
- Drejtuesit e linjës të kategorive të ulëta dhe të mesme, të cilët kanë nevojë të njohin Ligjin e ri të Shërbimit Civil dhe të kuptojnë ndryshimet që ai paraqet në mënyrën se si të ndërveprojnë me personelin e tyre.

Pritshmëritë e këtyre dy grupeve do të jenë domosdoshmërisht të ndryshme dhe për këtë arsye është e domosdoshme të barazpeshojmë përmbajtjen e modulit me qëllim që të plotësojmë nevojat e të dy tipeve të të trajnuarve.

Qëllimi i përgjithshëm i modulit në tërësi mund të shprehet si dhënës informacioni, njohurish dhe mjetesh të mjaftueshme praktike për t'u bërë të mundur si nëpunësve të thjeshtë ashtu dhe drejtuesve të nivelit të mesëm të BNJ të punojnë në mënyrë efikase sipas kuadrit të ri rregullator të parashikuar nga Ligji për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

Një mënyrë për të arritur këtë rezultat është marrja në konsideratë e dallimeve midis publikut si një pasuri dhe jo si humbje. Kjo gjë bëhet duke mbajtur parasysh se gjatë ciklit të trajnimit, ndërveprimet ndërmjet të trajnuarve mund të krijojnë përfitime të tjera konsiderueshme, përveç atyre që transmetojnë trajnerët.

Për ta përdorur këtë efekt, përbërja e grupeve të punës nuk duhet të jetë e rastësishme, por e përgatitur më parë, në mënyrë që secili grup të ketë barazpeshën e duhur midis profesionistëve të BNJ dhe atyre të linjës, si dhe midis niveleve të ndryshme të nëpunësve civilë.

Një kategori e tretë e grupit të synuar përfaqësohet nga nëpunësit e sapo rekrutuar civilë që do të ndjekin trajnimin e detyrueshëm të njohjes me administratën civile. Kështu, pjesë specifike të nën-moduleve të përshkruara në detaje më poshtë do të shërbejnë si bazë për lëndët e MBNJ të mbuluara në trajnimin njohës.

SUB-MODULE 1: CIVIL SERVICE LEGISLATION

1.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit

Të bëjë të trajnuarit të kuptojnë mirë përmbajtjen, arkitekturën dhe qëndrueshmërinë e Legjislacionit të Shërbimit Civil.

1.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve

Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i përgjithshëm

- Të kuptohet natyra e Shërbimit Civil, e përcaktuar në nenin 1 të LSHC si " i qëndrueshëm, profesional, i bazuar në meritë, integritet moral, paanësi politike dhe llogaridhënie" dhe çfarë nënkupton kjo në aspektin e rregullave dhe procedurave të MBNJ.

Njohuritë

- Të njohurit dhe të kuptuarit e strukturës së Ligjit për Shërbimin Civil;
- Të njohurit dhe të kuptuarit e hierarkisë së normave (Ligj, Vendim i Këshillit të Ministrave, Udhëzim i DAP-it) që rregullojnë shërbimin civil;
- Të krijuarit e një ideje të qartë të larmisë së dokumenteve të lidhura me çështjet e ndryshme të BNJ;
- Të qenët i vetëdijshëm për burime të tjera ligjore (ligje të tjera, vendime gjyqësore, vendime të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil)

Aftësitë

- Të qenët në gjendje për të gjetur informacionin e nevojshëm në kuadrin ligjor të Shërbimit Civil për të zgjidhur problemet profesionale të përditshme;

- Të qenët në gjendje për të shkruar një memo të qartë ku të përmbliiden dispozitat ligjore që rregullojnë një çështje ose procedurë të MBNJ

1.3 Profili i trajnerëve

Trajnerët do të jenë profesionistë nga DAP; juristë të ardhur nga Universitetet, profesionistë nga Zyra e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

1.4 Përmbajtja e detajuar e sesioneve të nën-moduleve

Dita 1

Paradite:

Prezantimi i Ligjit për shërbimin civil dhe akteve nënligjore

Pasditë:

ndarja deri në 6 grupe sipas numrit të pjesëmarrësve për seancën. Çdo grup do të jetë i ngarkuar të kryejë një hu-lumtim ligjor mbi një temë specifike të BNJ. Rezultati i kësaj pune do të shfrytëzohet si bazë për të ndërtuar nën-modulet e mëtejshme mbi të

Temat:

- Rekrutimi në Shërbimin Civil
- Transferimi paralel dhe ngritja në detyrë
- Përshkrimi i vendit të punës/analiza e vendit të punës
- Vlerësimi i performancës individuale
- Të drejtat dhe detyrat e nëpunësve civilë/disiplina
- Trajnimi

Më pas, secili grup do të përgatisë një memo mbi temën e caktuar, të përbërë nga tre pjesët në vijim:

- Përmbledhje e dispozitave ligjore lidhur me temën
- Përshkrimi i detyrave që duhet të kryejnë aktorët e ndryshëm (drejtuesit dhe drejtorët operacionalë, njësitë e burimeve njerëzore të agjencive / ministrive, DAP, të tjerë)
- Një listë pyetjesh për t'u sqaruar (nëse ka).

Dita 2

Paradite:

Prezantimi i punës së bërë nga secili grup, përmbledhja nga trajnerët

Pasditë:

Vazhdimi i prezantimeve në grupe, sinteza dhe përfundimet e përgjithshme për nën-modulin.

1.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar

Prezantimi teorik

Prezantimi i përgjithshëm i Legjislacionit të Shërbimit Civil që mbulon sa më poshtë:

- Qëllimi i përgjithshëm i Ligjit dhe risitë kryesore në krahasim me kuadrin ligjor të mëparshëm;
- Struktura e Ligjit për Shërbimin Civil: paraqitja e shkurtër e kapitujve të ndryshëm të Ligjit;
- Hierarkia e normave (Ligji, Vendimet e Këshillit të Ministrave, Udhëzimet e DAP-it) që rregullojnë shërbimin civil: të jepet një ide e qartë për larinë e dokumenteve në lidhje me temat e ndryshme të BNj dhe vlerën e tyre;

- Përmendje e burimeve të tjera ligjore (ligje të tjera, vendimet gjyqësore, vendimet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil) që mund të ndikojnë në Shërbimin Civil.

Raste praktike

Ushtrimet praktike do të zhvillohen në bazë të nevojave të trajnimit dhe shkëmbimeve të rregullta me DAP.

Ushtrimet e propozuara mund t'u kërkojnë pjesëmarrësve:

- Të kërkojnë në kuadrin ligjor për një funksion të BNJ-së - për shembull: "shpjegoni hapat dhe kërkesat për plotësimin e vendeve të lira në nivelin e mesëm drejtues, me referencat e duhura tek ligjii dhe aktet nënligjore"
- Ose të shqyrtojnë një situatë praktike - për shembull "Zonja N. konsideron se ajo nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë në vlerësimin e fundit të performancës. Çfarë hapash mund të ndërmerret? Në cilat raste do të ketë sukses?"

Mjetet e dobishme

Si pjesë e trajnimit, pjesëmarrësve mund t'u ofrohen mjetet e mëposhtme:

- Një version i konsoliduar i ligjeve 152/2013 dhe 178/2014;
- Një tabelë përputhshmërie midis neneve të Ligjit për shërbimin civil dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave (shih shembullin në Shtojcën 1;
- Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar

Testimi përfundimtar

Në fund të nën-modulit, testimi individual do të përbëhet nga PDP mbi kuadrin ligjor të Shërbimit Civil.

NËN-MODULI 2: VLERAT, ETIKA DHE DISIPLINA

2.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit

- Pjesëmarrësit të bëhen të vetëdijshëm për vlerat e Shërbimit Civil, rëndësinë e veprimit sipas një kodi etike dhe për domosdoshmërinë që nëpunësit civilë të mbajnë një qëndrim të drejtë dhe të disiplinuar;
- Drejtuesit të trajnohen për të drejtuar siç duhet departamentet e tyre nën konceptin e “qeverisjes së mirë” në mënyrë që të shmangët sjellja e keqe në punë dhe paraqitja e rreziqeve të ndryshme etike.

2.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimi kyç që u jepen të trajnuarve Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i përgjithshëm

- Të kuptuarit e vlerave të një shërbimi profesional civil: përkushtimi ndaj interesit të përgjithshëm, respekti dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve pavarësisht nga opinioni politik, besimi apo origjina; angazhimi për të punuar duke përdorur paratë publike, etj;
- Të kuptuarit e marrëdhënies midis vlerave & sjelljes etike dhe sjelljes së nëpunësit civil në veprimtarinë e tij/saj profesionale;
- Të kuptuarit e pasojave të keqmenaxhimit ose të procedurave të gabuara;
- Të zhvilluarit e mendësisë së përgjegjësisë.

Njohuritë

- Të njohurit dhe të kuptuarit se çfarë është kodi i etikës, cilat janë parimet e etikës dhe integritetit, dhe veprimet dhe sjelljet e ndryshme konkrete që këto vlera nuk i lejojnë.

- Të njohurit dhe të kuptuarit e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil, siç përcaktohet nga Ligji për Shërbimin Civil, si dhe shkeljet disiplinore dhe shkallën e sanksioneve.
- Të dihet se cilat veprime të një nëpunësi civil mund të cilësohen si kundërvajtje ose krime dhe janë të dënueshme sipas Kodit Penal.
- Të dihet si të zbulohen dhe vlerësohen rreziqet e lidhura me keqmenaxhimin ose procedurat e gabuara

Aftësitë

- Të kuptuarit se drejtuesit pritet japin shembullin e sjelljes etike dhe të veprojnë në përputhje me të.
- Të qenët në gjendje të zbulohet se kur një vartës apo koleg jep shenja të sjelljes jo etike dhe të marrit me çështjen përpara se situata të bëhet më serioze.
- Të qenët në gjendje të të marrit me situatën kur një vartës apo koleg dyshohet për shkelje serioze të etikës.
- Të qenët në gjendje të kuptohen dhe ndryshohen procedurat ose metodat e drejtimit kundrejt nëpunësve civilë kur ata mund të krijojnë riskun e sjelljes joetike

2.3 Profili i trajnerëve

Trajnerët do të jenë: profesionistë nga DAP; drejtues; gjyqtarë, juristë, anëtarë të Inspektorateve ose institucioneve të auditimit dhe kur është e mundur një psikolog për raste të veçanta studimore dhe ushtrime praktike.

2.4 Përmbajtja e detajuar e sesioneve të nën-moduleve

Dita 1

Paradite:

Risku që vjen nga nëpunësit civilë

- Vlerësimi i riskut
- Vlerat e Shërbimit Civil, çfarë është sjellja etike? Përkufizimi – Kodi i etikës: prezantim nga trajner (i/ët) pasuar nga një diskutim i hapur me grupin
- Shkeljet e shpeshta të etikës ose sjellja e pahijshme

Pasditë:

Administrimi

- Si të sillemi kur jemi në pozicion epror (eprori i drejtpërdrejtë, Njësia e BNJ) kundrejt një sjellje-je të pahijshme/jo etike
- Vlerësimi i riskut: si të shohim shenjat e alarmit në procedura dhe çfarë të bëjmë
- Risku që vjen nga keqmenaxhimi: pasojat dhe si të mbrohemi
- Masat nxitëse: një sigurim i mirë kundra sjelljes së pahijshme
- Marrëdhënia midis "etikës" dhe "qeverisjes së mirë" – siç është përcaktuar nga OECD;
- "Qeverisja e mirë" dhe "përgjegjësia"

Dita 2

Raste studimore praktike

Trajnimi i nëpunësve civilë që, gjatë gjithë kohës, të kenë qëndrim të drejtë etik në detyrën e tyre, të jenë plotësisht të angazhuar për interesin e përgjithshëm të qytetarëve, të jenë përgjegjës për veprimet e tyre dhe të jenë vetë ata pengesa më e mirë kundër tundimit për të thyer rregullat.

2.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar

Prezantimi teorik

- Vlerësimi i riskut të jashtëm;
- Vlerësimi i riskut të brendshëm;
- Parimet e përgjithshme të etikës;
- Legjislacioni shqiptar mbi integritetin dhe etikën
- Lidhja midis "etikës" dhe "qeverisjes së mirë";
- "Qeverisja e mirë" dhe "përgjegjësia"

Raste praktike

Ushtrimet praktike do të zhvillohen në bazë të nevojave të trajnimit dhe shkëmbimeve të rregullta me DAP.

Ushtrimet e propozuara dhe rastet ligjore mund të trajtojnë çështjet e mëposhtme:

Strategjia e etikës: Drejtimi nxitës dhe qeverisja e mirë

- Si të sillemi kur jemi në pozicion epror (eprori i drejtpërdrejtë, Njësia e BNJ) kundrejt një sjelljeje të pahijshme/jo etike
- Vlerësimi i riskut: si të shohim shenjat e alarmit në procedura dhe çfarë të bëjmë
- Risku që vjen nga keqmenaxhimi: pasojat dhe si të mbrohemi
- Masat nxitëse: një sigurim i mirë kundra sjelljes së pahijshme

Mjetet e dobishme

Si pjesë e trajnimit, pjesëmarrësve mund t'u ofrohen mjetet e mëposhtme:

- Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar;
- oO.30.3 Parimet e administratës publike, 2017 – OECD - SIGMA; http://www.sigmaxweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration_Edition-2017_ENG.pdf;
- Kodet e Etikës dhe Kodet e Sjelljes në Vendet anëtarë të OECD - <http://www.oecd.org/gov/ethics/ethicscodesandcodesofconductinoecdcountries.htm>
- Ligji nr. 9131 / 08.09.2003 per Rregullat e Etikes ne Administraten Publike

Testimi përfundimtar

Në fund të nën-modulit testimet individuale do të përbëhen nga PDP mbi kuadrin ligjor dhe rastet studimore. (Shih shembujt e rasteve studimore në Shtojcën 2).

NËN- MODULI 3: ANALIZA DHE PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS; REKRUTIMI

3.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit

Të pajisë të trajnuarit me një kuptim të përgjithshëm të rregullave në fuqi për analizën & përshkrimin e vendit të punës, për procedurat e rekrutimit, si dhe t'u paraqesë mjetet e dobishme operacionale.

3.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimet kyçe që u jepen të trajnuarve Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i përgjithshëm

- Kuptimi i mirë i përdorimeve të ndryshme përshkrimit të vendit të punës si një mjet i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Kuptimi i mirë i procedurave të rekrutimit, periudhës së provës, emërimit në shërbimin civil, ngritjes në detyrë dhe transferimit paralel, sipas kuadrin ligjor aktual. LSHC (Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të miratuar më 30 maj 2013, ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014)

Njohuritë

- Procedurat aktuale të krijuara për të hartuar dhe miratuar përshkrimet e vendeve të punës
- Dallimi midis përshkrimeve të përgjithshme dhe specifike të vendit të punës
- Plani Vjetor i Personelit të Shërbimit Civil: përmbajtja, procedura e përgatitjes, përdorimi
- Roli dhe përbërja e Komitetit të Përhershëm të Pranimit dhe të Komisioneve të ngritura në nivel institucioni për transferime paralele, ngritje në detyrë dhe pranime

Aftësitë

- Si hartohen apo vlerësohen përshkrimet e vendeve të punës
- Si përgatitet kontributi i njësisë suaj në Planin Vjetor të Personelit të Shërbimit Civil
- Si gjendet përgjigjja e duhur ligjore në procedurat e rekrutimit

3.3 Profili i trajnerëve

Trajnerët do të jenë specialistë të analizës dhe përshkrimit të vendit të punës, si dhe për procedurat e rekrutimit. Trajnerët do të jenë profesionistë nga DAP; juristë të specializuar; profesionistë të BNJ nga ministritë e linjës.

3.4 Përmbajtja e detajuar e sesioneve të nën-moduleve

3.4.1 Analiza dhe përshkrimi i vendit të punës

Dita 1

Paradite:

Parimet teorike dhe rregullat mbi përshkrimet e vendeve të punës

- Përdorimet e ndryshme të përshkrimit të vendit të punës (për klasifikimin e vendeve të punës, rekrutimin, vlerësimin e performancës, përshkrimin e organizatave)
- Dallimi midis përshkrimeve të përgjithshme dhe përshkrimeve specifike të vendeve të punës
- Kuptimi i elementeve të ndryshëm të një përshkrimi të vendit të punës
- Përdorimi i një fjalori të saktë

Pasdite:

Ushtrime praktike sipas modelit "nga lart-poshtë".

- Të trajnuarve do t'u kërkohet të shqyrtojnë dhe korrigjojnë disa përshkrime ekzistuese të vendeve të punës;
- Të trajnuarve do t'u kërkohet të shkruajnë përshkrime specifike të vendeve të punës.

Dita 2

Paradite:

Si shkruhet një përshkrim vendi pune

1. Kuptimi i logjikës së dispozitave të LSHC për analizat e vendeve të punës dhe përshkrimet e vendeve të punës
2. Si të lundrosh nëpër labirintet e ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve mbi këtë temë (kjo pikë përfshin dhënien e udhëzimeve praktike për ushtrimin e parë të pasdites)
3. Sqarime mbi kërkesat e secilës pjesë të formularit të përshkrimit të vendit të punës
4. Sqarim mbi fjalorin dhe terminologjinë e përdorur

Pasdite:

Ushtrime praktike në grup sipas metodës "nga poshtë-lart"

Ushtrimi i metodës "nga poshtë-lart" merret me hartimin e një përshkrimi specifik të vendit të punës "të krijuar nga e para"

3.4.2 Rekrutimi

Dita 1

Paradite: Parimet dhe rregullat e procesit të rekrutimit

- Kuptimi i logjikës së dispozitave të LSHC për rekrutimet
- Si të lundroh nëpër labirintet e ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve mbi këtë temë (kjo pikë përfshin dhënien e udhëzimeve praktike për ushtrimin e parë të pasdites)
- Çfarë është Plani Vjetor i Personelit të Shërbimit Civil dhe pse është i rëndësishëm për të gjitha njësitë administrative

Pasdite: prezantimi praktik i procedurës së rekrutimito

- Ky sesion shkon në mënyrë skematike përmes hapave të njëpasnjëshme të procedurave të ndryshme të lidhura me rekrutimin.

Dita 2

Paradite: "kleçkat" e intervistës të mësura nga praktika e MBNJ

- Sesioni do të përqendrohet në përgatitjen, organizimin dhe kryerjen e intervistës së rekrutimit

Pasdite: Punë praktike në grup

Intervista e simuluar dhe loja e roleve

Intervista e simuluar është simulimi i një interviste pune që përdoret për qëllime trajnimi. Ky ushtrim bise-dor i ngjan një interviste të vërtetë sa më shumë të jetë e mundur, me qëllim që të krijohet përvoja për inter-vistuesit dhe të intervistuarit. Intervistat e simuluar janë më të zakonshmet në procesin e rekrutimi dhe përdoren gjithashtu për të trajnuar figurat publike për të perballuar pyetjet e gazetarëve ose për të përgatitur kandidatët në zgjedhje për debate

3.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar

3.5.1 Analiza dhe përshkrimi i vendit të punës

Prezantimi teorik

- Pajisja me ligjin e shërbimit civil, me aktet nënligjore dhe udhëzimet në fushën e klasifikimit të vendit të punës dhe përshkrimet e vendeve të punës;
- Prezantimi i hollësishëm i formularëve të përshkrimit të vendit të punës

Raste praktike

Ushtrimet praktike do të zhvillohen në bazë të nevojave të trajnimit dhe shkëmbimeve të rregullta me DAP.

Ushtrimet e propozuara mund të trajtojnë çështjet e mëposhtme:

- Përshkrimin e vendeve të punës;
- Përdorimin e fjalorit të duhur në procesin e përcaktimit të përshkrimit të vendeve të punës;
- Ushtrimin e përdorimit të përshkrimit të vendeve të punës për qëllime të ndryshme si: strukturimi / ristrukturimi i organizatave publike, klasifikimi i pozicioneve hierarkike brenda organizatës në bazë të përmbajtjes së tyre; rekrutimin i personelit; vlerësimi i performancës së punonjësve.
- Si bazë për ushtrimet do të shërbejë modeli i bazuar në kompetenca i zhvilluar për TND

3.5.2 Rekrutimi

Prezantimi teorik

- Kuadri i përgjithshëm ligjor për rekrutimin
- Parimet drejtuese të procedurave të pranimit në shërbimin civil
- Kërkesa të përgjithshme për t'u pranuar në shërbimin civil
- Parimet themelore në organizimin e transferimeve paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit
- Hapat proceduralë të të gjitha procedurave të pranimit që rregullohen me Ligjin për Shërbimin Civil.

Raste praktike

Ushtrimet praktike do të zhvillohen në bazë të nevojave të trajnimit dhe shkëmbimeve të rregullta me DAP.

Loja e roleve, rastet studimore dhe ushtrimet e propozuara do të trajtojnë temat e mëposhtme:

- Lidhja midis kërkesave të vendit të punës dhe përgatitjes së procedurës së pranimit;
- Dallimi midis testimit me shkrim dhe intervistës;
- Përgatitja, organizimi dhe kryerja e intervistës së pranimit
- Si bazë për ushtrimet do të shërbejë modeli i bazuar në kompetenca i zhvilluar për TND

Mjetet e dobishme

Si pjesë e trajnimit, pjesëmarrësve mund t'u ofrohen mjetet e mëposhtme:

- Modeli i bazuar në kompetenca (shih përshkrimin e detajuar të kuadrit të kompetencave për TND në shtojcën 3 dhe kuadrolin e bazuar tek kompetencat në sistemin polak në shtojcën 4);
- Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar;
- Metodologjia për diagnostikimin e burimeve njerëzore brenda organizatave publike (shih shembujt në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të përmendur më lart);
- Modeli i përshkrimit të vendit të punës;
- Tabelat e vlerësimit të paracaktuara nga komitetet e përzgjedhjes (shih shembujt në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të përmendur më lart);
- Modele të punës praktike për çdo fazë të procedurave të rekrutimit

Testimi përfundimtar

Në fund të nën-modulit testimet individuale do të përbëhen nga PDP mbi kuadrin ligjor dhe rastet studimore.

NËN- MODULI 4: MENAXHIMI I PERSONELIT/ PERFORMANCËS INDIVIDUALE

4.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit

Të kuptohen mirë objektivat, metodat dhe mjetet e menaxhimit të personelit, si dhe të roleve dhe përgjegjësive përkatëse të hierarkisë operacionale (eporët e drejtpërdrejtë dhe të nivelit n + 2) dhe njësisë së BNJ të organizatës.

4.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve

Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i përgjithshëm

- Përshkrimi i objektivave të menaxhimit të personelit në nivel organizate
- Përçimi i konceptit se drejtuesit e linjës kanë përgjegjësi të rëndësishme në drejtimin e Burimeve Njerëzore dhe duhet t'i kushtojnë kohë dhe vëmendje të mjaftueshme detyrës (p.sh: roli i eporit të drejtpërdrejtë si nëpunësi i parë i BNJ)
- Krijimi i vetëdijes tek të trajnuarit për hulumtimin në lidhje me stilet e ndryshme të Menaxhimit dhe drejtimit
- Përçimi i nocionit se vlerësimi i performancës nuk duhet të shihet si një praktikë ndëshkuese, por si një dialog për të ndihmuar vartësit të përmirësojë performancën e tyre

Njohuritë

- Kuadri i Menaxhimit të personelit (në bazë të punës së bërë në nën-modulin 1): nocionet e përgjithshme mbi disiplinën në Shërbimin Civil, të drejtat dhe detyrat e nëpunësve civilë
- Si të përdoren mirë të dhënat e përfuara nga vlerësimet e performancës

- Drejtimi i karrierës: çfarë është dhe si ta zbatojmë atë
- (Për profesionistët e BNJ): organizimi i fushatës së vlerësimeve të performancës në një organizatë administrative
- (Për drejtuesit e nivelit të mesëm): të përgatisin dhe të kryejnë vlerësimin e performances.

4.3 Profili i trajnerëve

Njëri prej trajnerëve do të jetë nga sektori publik, qoftë profesionist i BNJ-së, apo edhe një drejtues operacional i mesëm me përvojë të mirë në drejtimin e ekipeve. Nëse do të jetë e mundur do të ftohen si trajnerë profesionistë nga sektori privat, psh një drejtues i lartë i burimeve njerëzore në një bankë, kompani sigurimi, telekomunikacioni ose ndonjë kompani tjetër të madhe shërbimi.

4.4 Përbajtja e detajuar e sesioneve të nën-moduleve

Dita 1

Paradite: Prezantimi i përgjithshëm i temës. Nocionet teorike.

Përshkrimi i rolit të drejtuesve të linjës dhe njësive të BNJ në drejtimin e përditshëm të personelit.

Përmbledhje e kërkimeve lidhur me stilet e drejtimit; pajisja me material të shkruar mbi temën

Funksionet e BNJ

Të trajnuarve u propozohet të plotësojnë një pyetësor vetë-vlerësimi i llojit "Sa të mira janë aftësitë tuaja të drejtimit?" ose "Gjeni stilin tuaj të drejtimit".

Pasdite: Vlerësimi i performancës

Detajoni interesin e vlerësimit përtej aspektit të performancës Shpjegoni se si duhet të përgatitet vlerësimi nga Njësia e Burimeve Njerëzore: të organizojë një informacion paraprak për drejtuesit, të përcaktojë një agjendë të saktë dhe afate për mbajtjen e intervistave dhe të dorëzojë procesverbalin, të shpërndajë në kohën e duhur një dokument shpjegues dhe formularët për zbardhjen e intervistës.

Përshkruani dhe shpjegoni procedurën që duhet ndjekur dhe dokumentet që duhen plotësuar. Trajtoni çështjen se si do zgjidhen ankesat dhe konfliktet.

Dita 2

Morning: Role-play

Loja e roleve

Do të propozohen dy lloje të ndryshme situatash, një për drejtuesit operacionalë, tjetra për profesionistët e BNJ. Të gjithë pjesëmarrësve do t'u kërkohet të përgatisin ushtrimet, lojën e roleve të luajtur nga vullnetarë.

Për drejtuesit operacionalë, ushtrimi do të jetë kryerja e vlerësimit të performancës së një vartësi mbi bazën e një situatë me shkrim duke përfshirë CV-në dhe përshkrimin e punës së vartësit si dhe një përmbledhje të asaj që ka bërë gjatë periudhës nën vlerësim.

Përgatitja me shkrim do të kryhet në grupe dhe qëndron në krijimin e një liste pyetjesh që do të bëhen gjatë intervistës. Për kryerjen e intervistës, një nga trajnerët duhet të luajë vartësin e intervistuar.

Do të luhen dy intervista të ndryshme, të bazuara në situata të ndryshme.

Për profesionistët e burimeve njerëzore, ushtrimi do të konsistojë në përgatitjen e njoftimit për drejtuesit e Drejtorisë së tyre mbi përgatitjen e fushatës së ardhshme të vlerësimit të performancës. Përgatitja me shkrim do të kryhet dhe në grupe, dhe qëndron në nxjerrjen e një strukture të informimit në formë prezantimi në PowerPoint. Për lojën që do zhvillohet, të trajnuarit e përzgjedhur do të luajnë rolin e drejtuesve që informohen dhe do të inkurajohen të bëjnë pyetje pas prezantimit.

Pasdite: Vazhdimi i lojës së roleve, informimi, përmbledhja dhe vërejtjet përmblyëse

4.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar

Prezantimi teorik

Kuadri i menaxhimit të personelit

(mbi bazën e punës së bërë në nën-modulin 1):

Drejtimi i personelit

- Roli i drejtuesve të linjës dhe njërive të BNJ në drejtimin e përditshëm të personelit
- Stilet e drejtimit
- Funkcionet e BNJ

Menaxhimi i performancës

- Vlerësimi i performancës si mjet drejtimi
- Drejtimi i bazuar në objektiva
- Vendosja e objektivave, treguesve dhe planit
- Organizimi i procesit (procedurat, pjesëmarrësit, dokumentet, etj.)
- Intervista dhe zgjidhja e konfliktit

Rastet praktike

Ushtrimet praktike do të zhvillohen në bazë të nevojave të trajnimit dhe shkëmbimeve të rregullta me DAP.

Menaxhimi i performancës

- Në grupe, të vendosen objektivat individuale për një nëpunës civil bazuar në
 - Profilin e punës,
 - Parametrat e organizatës,
 - Raportimi i aktivitetit individual.
- Prezantime në grup dhe diskutime të përgjithshme

Intervista e performancës

- Në grupe, përgatiten një sërë pyetjesh për intervistën e vlerësimit të performancës, në bazë të:
 - Curriculum Vitae;
 - Përshkrimit të vendit të punës;
 - Raportimi i aktivitetit individual.
- Loja e roleve: intervista e performancës

Mjete të dobishme

Si pjesë e trajnimit, pjesëmarrësve mund t'u ofrohen mjetet e mëposhtme:

- Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar;
- Formularët e vlerësimit;
- Udhëzimet për intervistën e vlerësimit.

Testimi përfundimtar

Dokumentet e shkruara të përgatitura nga të gjitha grupet mund të mblidhen dhe diskutohen nga trajnerët si pjesë e përmbledhjes.

NËN- MODULI 5: TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

5.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit

Të përçojë tek pjesëmarrësit rëndësinë kyçe të trajnimit dhe t'u ofrojë atyre mjetet dhe metodat për të shfrytëzuar sa më mirë mundësitë e trajnimit, si për efikasitetin e organizatës ashtu edhe për zhvillimin e personelit.

5.2 Rezultatet e pritshme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve

Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i përgjithshëm

- Të ndryshojë mënyrën se si pjesëmarrësit e shohin trajnimin: për drejtuesit nuk duhet të konsiderohet bezdi, por një mënyrë për të përmirësuar efektivitetin e tyre dhe të njësisë së tyre.
- Të kuptohet se një organizim i mirë trajnimi ka nevojë për një bashkëpunim të mirë mes drejtuesve të linjës dhe BNJ
- Të kuptohet roli i ASPA

Njohuritë

- Njohja me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil mbi trajnimin
- Njohuria se çfarë është vlerësimi i nevojave për trajnim (VNT dhe si ta realizoni atë në organizatën tuaj

Skills

Vlerësimi i dobisë së trajnimeve dhe i efektivitetit të programeve të trajnimit.

- Ndërveprimi me ofruesit e trajnimit për të përbushur më

mirë nevojat e organizatës suaj

5.3 Profili i trajnerëve

Për këtë modul, njëri trajner do të jetë profesionist i BNJ (Drejtor i Burimeve Njerëzore në një Ministri ose Agjenci ose një anëtar i DAP-it) dhe tjetri anëtar i personelit të ASPA-s.

5.4 Përbajtja e detajuar e sesioneve të nën-moduleve

Dita 1

Paradite: Nocione të përgjithshme

- Trajnimi për Ligjin e Shërbimit Civil, organizimin e trajnimeve në Shërbimin Civil,
- Organizimi i ASPA-s, roli i pjesëmarrësve të ndryshëm (Drejtuesit e lartë, njësitë e BNJ, drejtuesit e linjës) në organizimin e trajnimit në nivel të Ministrie dhe Drejtorie.
- Si kryhet një VNT: objektivat, burimet e informacionit, metodologjia

Pasditë:

- Si vlerësohet dobia e ofertave të trajnimit dhe efektiviteti i programeve të trajnimit.
- Si të bashkëveprohet me ofruesit e trajnimit për të përbushur më mirë nevojat e organizatës suaj.

Dita 2

Paradite: Ushtrime praktike në grupe (lojë në role)

Pasditë:

- Testimi përfundimtar
- Informimi, përmbledhja dhe vërejtjet e fundit

5.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar

Prezantimi teorik

- Pajisja me ligjin e Shërbimit civil, me aktet nënligjore të tij dhe me udhëzimet në fushën e trajnimit dhe të Shkollës së Administratës Publike;
- Nacionet mbi vlerësimin e nevojave për trajnim, vlerësimi dhe cilësia e trajnimit.

Raste praktike

- Ushtrim praktik në grupe (loja e roleve): çdo grup do të përgatisë situatën e mëposhtme: "Ju jeni nëpunës i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të një Ministrie që ka dërguar disa punonjës në kursin e Menaxhimit dhe zhvillimit të BNj të organizuar nga ASPA. Do të keni dëshirën të dërgoni më shumë personel në të njëjtin kurs vitin e ardhshëm, por mendoni se do të duhen disa përmirësime. Keni kërkuar një takim me përfaqësuesit e ASPA-s për të diskutuar ndryshimet që propozoni".
- oO.30.3 Njëri nga gupet apo të gjitha grupet do të inskenojnë takimin, trajnerët do të luajnë rolin e përfaqësuesve të ASPA-s.

Mjetet e dobishme

Si pjesë e trajnimit, pjesëmarrësve mund t'u ofrohen mjetet e mëposhtme:

- Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar;
- Metodologjia e vlerësimit të nevojave për trajnim në Manualim e Procedurave të ASPA i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar;
- Formularët e vlerësimit të cilësisë në Manualin e Procedurave të ASPA i hartuar me mbështetjen e projektit të Binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar;

Final test

Katër modulet e para përmbajnë shumicën e njohurive dhe aftësive operacionale që moduli i MBNJ ka për qëllim të përcjellë, kurse i fundit është në thelb zbatim në jetën reale. Meqenëse moduli i trajnimit është paksa më i lehtë në përmbajtje sesa të tjerët, sugjerohet që të lihet pak kohë për të bërë një test vlerësimi të përvetësimeve të të trajnuarve nga katër modulet e para.

Për këtë qëllim mund të kryhet një testim me PDP prej 20 minutash.

NËN-MODULI 6: HARTIMI I PROLIKAVE DHE STRATEGJIVE PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Shënime paraprake për këtë nën-modul

Qëllimi i këtij nën-moduli është që secili grup i të trajnuarve të zhvillojë një dokument strategjik mbi një njësi administrative reale. Për këtë qëllim, do të jetë e nevojshme të merren masa të veçanta.

Sapo të krijohen grupet e punës në fillim të modulit, secilit grup do i kërkohet të zgjedhë një njësi administrative (Drejtori, Drejtori e Përgjithshme, Agjenci) për të cilën ata propozojnë të përgatisin një dokument strategjik. Përzgjedhja do të varet kryesisht nga lehtësirat që anëtarët e grupit do të gëzojnë për të mbledhur të dhëna dhe informacione mbi MBNJ në njësi.

Zgjedhja do duhet të bëhet së bashku me të dy trajnerët, të cilët duhet ta miratojnë si dhe do të merret miratimi i Autoriteteve përgjegjëse të organizatës së përzgjedhur.

Pasi të jetë marrë ky autorizim, grumbullimi i të dhënave dhe informacionit si dhe përgatitja e studimit do të vazhdojë deri në ditën e parë të nën-modulit.

Trajnerët e përzgjedhur për zhvillimin e nën-modulit do të udhëheqin grupet dhe do t'u japin udhëzime për zhvillimin e studimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së modulit.

Trajnerë të tjerë do të veprojnë si persona burimorë gjatë gjithë modulit, kryesisht për të treguar se çfarë lloj informacioni do të jetë i nevojshëm ose i rëndësishëm si dhe për të ofruar informacion dhe këshilla mbi çështjet që lidhen me fushën specifike që po mësohet.

6.1 Qëllimi i përgjithshëm i nën-modulit

Grupi duhet të kuptojë se cilat janë politikat dhe strategjitë e MBNJ në nivel të Shërbimit Civil në tërësi, të një Ministrie apo një Drejtorie të Përgjithshme dhe mënyrën se si ndërliken nivelet e ndryshme.

6.2 Rezultatet e prishme dhe përvetësimt kyçe që u jepen të trajnuarve Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i përgjithshëm

Të përftohet një kuptim i përgjithshëm i çështjeve të politikës dhe evolucionit të burimeve njerëzore në sektorin publik : se si ndërliken pjesët e ndryshme të saj (rekrutimi, trajnimi, emërimi, paga); cilët janë faktorët që ndryshojnë lojën (mundësitë e reja të ofruara nga IT, konkurrenca për talentet, niveli i lartë i arsimit në shërbimet civile, çështjet gjinore dhe të barazisë etj)

Njohuritë

- Njohja e përmbajtjes dhe strukturës së një dokumenti strategjik në fushën e menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe pikat kyçe që duhet të mbulojë në nivele të ndryshme.
- Njohja me procedurat kryesore të BNJ, dokumentet dhe mjetet e menaxhimit të BNJ në organizatat qeveritare.

Aftësitë

- Të qenët në gjendje për të marrë pjesë / kryer studime strategjike si dhe për të hartuar dokumente të politikave në fushën e MBNJ.
- Të analizuarit e politikës së ndjekur për menaxhimin e burimeve njerëzore në një organizatë të caktuar; përcaktimi i kufizimeve: kuadri ligjor, buxheti, sistemet ekzistuese të IT-së.
- Të formuluarit e objektivave kryesore që duhen ndjekur.
- Të përcaktuarit e një strategjie për të përmbushur objektivat e zgjedhura.

6.3 Profili i trajnerëve

Njëri nga trajnerët do të jetë një profesionist i nivelit të lartë dhe me përvojë (Drejtor i BNJ në një Ministri ose Agjenci të madhe) dhe tjetri ekspert dhe ushtrues i menaxhimit strategjik.

6.4 Detailed content of the sub-module sessions

Dita 1

Paradite: Përgatitje

Organizimi i grupeve, informimi mbi zhvillimin e nën-modulit.

Pasdite: Teori

Funksioni i BNJ, përbërësit kryesorë ; nocione të përgjithshme mbi qasjen strategjike për organizatat publike ; disa mjete në funksion të analizës

Dita 2

Paradite: Metodologji

Si të hartohet një dokument strategjik – udhëzime hap pas hapi

Dita 3

Paradite: Punë në grupe – Përfundimi i dokumenteve strategjike ; përgatitje për prezantimin me gojë

Dita 4

Paradite: Prezantimi i strategjive – diskutime

Pasdite: Prezantimi i strategjive dhe diskutime (vazhdimi) – përmbledhja

- Fundi i modulit -

6.5 Përmbledhje e organizimit të nën-modulit: mjetet, referencat, testimi përfundimtar

Prezantimi teorik

- Përbërësit kryesorë të funksioneve të BNJ,
- Përshkrimi i përgjithshëm i qasjes strategjike të zbatuar në shërbimet publike,
- Hyrje në mjetet e analizës
- Analiza e të dhënave, identifikimi i kufizimeve, përcaktimi i objektivave
- Metodologjia: udhëzues hap pas hapi për zhvillimin e një studimi strategjik dhe hartimin e një dokumenti politike

Raste praktike

- Ushtrime në grup: hartimi i dokumentit të politikës së BNJ për një institucion publik të caktuar.

Zgjedhja e entiteteve që do të jenë subjekt i rasteve studimore është një faktor kyç për suksesin e projektit të trajnimit.

Entiteti duhet të ketë madhësi të mjaftueshme për të justifikuar zhvillimin e një strategjie të veçantë të burimeve njerëzore, por gjithashtu madhësia duhet të bëjë të mundur që çështjet dhe problemet të kapen lehtësisht. Ky mund të jetë rasti për një Drejtori të Përgjithshme; Drejtori, ose një agjenci të varësisë të mesme në të madhe.

Bashkëpunimi i drejtuesve të lartë të entitetit është absolutisht i domosdoshëm. Minimalisht ata do të duhet të autorizojnë ushtrimin dhe mundësisht duhet të jenë bashkëpunues dhe ta shohin si potencialisht të dobishëm për institucionin.

Mjete të dobishme

Të tajnuarve duhet t'u vihen në dispozicion materiale bazë të komentuar dhe të diskutuar, me qëllim që të mbulojnë konceptet kryesore të përfshira në procesin e hartimit të politikave dhe strategjive të BNJ, përkatësisht:

- Komponentët kryesorë të funksionit të BNJ;
- Dallimi midis Menaxhimit së personelit dhe strategjisë së BNJ
- Koncepti i strategjisë për organizatat publike
- Disa mjete të përdorura zakonisht (analiza e hendekut, analiza SWOT).

Testimi përfundimtar

Testimi do të jetë cilësia e strategjive të përgatitura, siç do të vlerësohet nga trajnerët dhe drejtuesit e njësisë së marrë në studim.

TABELA E PËRPUTHSHMËRISE: LIGJI PËR NËPUNËSIT CIVILË / AKTET NËNLIGJORE DHE MANUALET

Neni Nr.	Neni në Ligjin për Nëpunësit Civile	Akti nënligjor	Manuali/udhëzimi
A 6 §1	Këshilli i Ministrave: a) miraton aktet nënligjore në bazë dhe në zbatim të këtij ligji; b) miraton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të institucioneve përgjegjëse për formimin profesional të nëpunësit civil.		
A 8 §11	Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishtme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASPA-s.	VKM nr.138, datë 12.03.2014, për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civile.	
A 9 §5	Këshilli i Ministrave miraton tarifat përkatëse.		
A 10 §2	Këshilli i Ministrave mund të vendosë që disa institucione të administratës shtetërore të krijojnë një njësi të përbashkët të menaxhimit të burimeve njerëzore apo që pjesë e funksioneve të njësisë të menaxhimit të burimeve njerëzore të një institucioni të varësisë të kryhen nga institucioni epror.		
A 17 §4	Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe Menaxhimin e dosjeve të personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe të përdorimit të të dhënave.	VKM nr 117 për përmbajtjen, procedurën dhe Menaxhimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit.	

A 18 § 3	<p>Këshilli i Ministrave miraton:</p> <p>a) rregullat për përmbajtjen, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planeve të pranimit;</p> <p>b) procedurat e hollësishme për përgatitjen dhe miratimin e planit të përgjithshëm të pranimit për institucionet e administratës shtetërore.</p>	VKM nr. 108, Datë 26.02.2014, Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil.	
A 19 § 9	<p>Këshilli i Ministrave miraton:</p> <p>a) klasat e zbatueshme për secilën nga kategoritë;</p> <p>b) përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grupet sipas këtij neni, si dhe grupet e Menaxhimit të posaçëm;</p> <p>c) kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grupet sipas këtij neni;</p> <p>ç) emërtesën e pozicioneve që bëjnë pjesë në çdo klasë, kategori apo grup;</p> <p>d) metodologjinë e klasifikimit të një pozicioni në një kategori, klasë dhe grup të caktuar.</p>	<p>VKM nr.142, Datë 12.03.2014, Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura.</p> <p>Plotësuar me:</p> <p>VKM nr.703, datë 29.10.2014 Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;</p> <p>VKM nr.719, datë 31.10.2014 Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.</p> <p>VKM nr.262, datë 25.03.2015 mbi disa ndryshime në VKM nr.142</p>	Udhëzimi i DAP nr 2, Datë 07.04.2014, për hartimin e pëshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil.
A 22 § 6	<p><i>Pranimi në Shërbimin Civil</i></p> <p>Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komiteteve të përhershme të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.</p>	VKM nr.143, datë 12.03.2014, Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese.	Udhëzimi i DAP nr 2, datë 27.03.2015, për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet

A 23 § 5	<i>Emërimi në Shërbimin Civil</i> Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme sipas këtij nen.	Zëvendësuar nga: VKM nr.242, datë 18.03.2015 për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.	procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur.
Neni i ndryshuar 26 § 4 & 9	<i>Ngritja në detyrë</i> Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese.	VKM nr.243, datë 18.03.2015 për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive.	
A 28 § 6	<i>Pranimi në TND nëpërmjet ASPA-s</i> Këshilli i Ministrave miraton kërkesat specifike për pranimin në TND dhe procedurën e hollësishme të pranimin në programin e formimit të thelluar në ASPA.	VKM nr.118, datë 5.3. 2014 për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së	Udhëzimi i DAP nr 6, datë 19.09.2014, për procesin e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë, anëtarë të TND
A 29 § 5	<i>Pranimi i drejtpërdrejtë në TND</i> Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe kërkesat specifike për pranimin në TND dhe procedurën e hollësishme të pranimin.		
A 30 § 6	<i>Caktimi i anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt</i> Këshilli i Ministrave miraton rregullat për menaxhimin dhe lëvizjen e anëtarit të TND-së.		
A 31 § 3	<i>Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në</i> Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për përbërjen, përzgjedhjen, vendimarrjen dhe pagesën e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.		
A 32 § 3	Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore Këshilli i Ministrave miraton rregullat e		

	hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komiteteve të përhershme të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.		
N 34 § 4	<i>E drejta e pagës dhe struktura e saj</i> Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave sipas këtij neni.		
N 39 § 3	<i>E drejta e konsultimit</i> Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për ushtrimin e së drejtës së konsultimit, sipas këtij neni		
N 40 § 2	Këshilli i Ministrave miraton rregullat për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit, për orët shtesë, kompensimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve të kryera për ushtrimin e detyrës jashtë vendit normal të punës.		
N 48 § 7	Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për transferimin e përkohshëm sipas këtij neni.	VKM nr 171, datë 26.03.2014 Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil.	Udhëzimi i DAP nr 3, datë 14.04.2014, Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit.
Neni i ndryshuar 50 § 9	<i>Transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit</i> Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.		

N 51 § 3	<i>Transferimi për arsye të paaftësisë shëndetësore.</i> Procedura e hollësishme e transferimit për paaftësi shëndetësore miratohet nga Këshilli i Ministrave.		
N 52 § 4	<i>Transferimi për shmangien e konfliktit të interesit.</i> Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme të transferimit sipas këtij neni.		
Neni i ndryshuar 56 § 5	<i>Efektet e pezullimit.</i> Këshilli i Ministrave miraton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni.		
A 59 § 10	Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, brenda rregullave të përgjithshme, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.	VKM nr. 115, datë 5.03.2014 Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil.	Udhëzimi i DAP nr 1, datë 02.04.2014. Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.
N 62 § 4	Këshilli i Ministrave miraton procedurën e hollësishme të vlerësimit të rezultateve në punë dhe kompetencat për vlerësimin.	VKM nr.109, datë 26.02.2014, për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë.	
N 66 § 5	Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme të lirimit nga shërbimi civil.		
N 67 § 8	Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.	VKM nr 116, datë 5.03.2014 Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “për nëpunësin civil”.	

Shtojca 2: Raste studimore për integritetin dhe sjelljen etike

A. Rastet studimore mbi çështje të Burimeve njerëzore:

BURIMET NJERËZORE	
Rasti studimor nr. 1	<p>Vladimir K. është nipi i Ministrisë të Bujqësisë të Maqedonisë. Ky ministër është politikisht i rëndësishëm sepse është kreu i vjetër i krahut të djathtë të partisë politike të Kryeministrit.</p> <p>Vladimiri është djalë shumë inteligjent dhe pas studimeve të shkëlqyera në një nga universitetet më të mira në botë, ai mori diplomën më të mirënjohur në fushën e tij të studimeve (energji hidroelektrike).</p> <p>Qeveria maqedonase vendosi të ndërtojë një digë të madhe për të siguruar energji elektrike në disa qytete të mëdha të vendit dhe është nën presionin e hartuesve të këtij projekti (një organizatë e rëndësishme ndërkombëtare) për të rekrutuar specialistë vendas për të mbikëqyrur ndërtimin. Aplikojnë disa kandidatë, mes tyre edhe Vladimiri.</p> <p>Dy nga këta kandidatë, më të mirët, Vladimiri dhe Gregori, kanë të njëjtën diplomë dhe konkurrojnë për pozitën e drejtuesit të ekipit të projektit. Atëherë Ministri i Bujqësisë i telefonon Kryeministrit që të marrë nipin e tij, dhe Kryeministri e bën këtë gjë, sepse ai ka nevojë për mbështetjen e krahut të djathtë të partisë së tij për të miratuar një ligj për mbrojtjen e fëmijëve që është shumë i rëndësishëm. Fëmijët janë më të rëndësishëm sesa mbrojtja e barazisë së mundësive për Gregorin, i cili për më tepër, nuk i përket partisë politike.</p> <p>Organizata ndërkombëtare e cila e dinte këtë mbështetje të fortë të padrejtë preferon të mbyllë gojën për arsye politike dhe në fund Vladimiri përzgjidhet dhe merr vendin e punës.</p>
Bëni një analizë gjithëpërfshirëse kritike të të gjitha fakteve dhe rolin e secilit aktor.	
Rasti studimor nr. 2	<p>Pas një procesi përzgjedhës në një spital për një kirurg të specializuar në ndërhyrjet kirurgjikale në tru, janë përzgjedhur tre kandidatë. Një burrë me reputacion të shkëlqyer në këtë fushë dhe dy gra, njëra specialiste në ndërhyrjet e zembrës dhe tjetra e shkëlqyer, por e papërvogë dhe shumë e bukur.</p> <p>Për dukje politike, dekani i spitalit vendos të rekrutojë më mirë një femër sesa një mashkull dhe kandidati mashkull refuzohet. Dekani në shikim të parë ra në dashuri me vajzën e re, por nën presionin e kolegëve të tij për shkak të mungesës së përvojës së saj, përfundimisht vendos të rekrutojë kirurgjen e zembrës. Një muaj më pas, përpara një rasti të vështirë, kirurgia e zembrës vret një fëmijë të vogël, sepse ajo nuk ishte në gjendje të praktikonte një operacion të komplikuar në tru. E dëshpëruar si nënë e një djali të vogël, ajo vendos të japë dorëheqjen. Nën presionin e situatës emergjente, kolegët i kërkojnë dekanit që të gjejë dikë sa më shpejt që të jetë e mundur, kështu që ai më në fund rekruton gruan e re të bukur që është e dashura e tij. Por gjërat përkeqësohen dhe ndodhin shumë vdekje të tjera. Kolegët e shtyjnë kirurgjen e re dhe dekanin që ta pushojnë nga puna dhe të thërrasë kandidatin e parë që pranon kundër pagesës së një rryshfeti shumë të rëndësishëm. Por ai arrin të shpëtojë së paku njëqind jetë.</p>

<p>Kreu i administratës me reagimin e tij mbrojti mjedisin dhe reputacionin e Qeverisë dhe u ngrit në detyrë. Lutemi jepni komentin tuaj.</p>	
<p>Cili është reagimi juaj duke marrë parasysh të gjitha detajet e këtij projekti?</p>	
<p>Rasti studimor nr. 3</p>	<p>Ju jeni përgjegjësi i departamentit të BNJ dhe vendimi i rekrutimit midis kandidatëve është në duart tuaja. Për një aplikim për pozicionin e specialistit të buxhetit (i cili është një pozicion mjaft i ndjeshëm), mund të zgjidhni midis pesë kandidatëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kandidati A i cili ka një përvojë të thellë në të njëjtin pozicion (20 vjet), por jo diplomën e nevojshme • Kandidati B i cili është shumë i ri, ka diplomën por nuk ka përvojë fare • Kandidati C i cili është përzgjedhur për herë të 5-të dhe meriton prej një kohe të gjatë ngritje në detyrë por nuk ka as përvojë dhe as diplomë • Kandidati D që ju e njihni tashmë se keni punuar me të, por është një person i lig i cili ka shpërndarë thashetheme të këqija kundër jush në të kaluarën, por ai ka edhe përvojën edhe diplomën • Kandidati E i cili ka diplomën dhe përvojën dhe ju ka dërguar një zarf me para brend
<p>Shpjegoni se kë do të zgjidhni dhe kë do të eliminoni dhe arsyet e zgjedhjes suaj</p>	
<p>Rasti studimor nr. 4</p>	<p>Çfarë do të zgjidhnit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rekrutoni dikë që është shumë afër eprorit tuaj, mund të jetë i dobishëm për karrierën tuaj • Të rekrutoni dikë që mund t'ju japë disa para në këmbim • Të rekrutoni dikë që është djali i një gazetari të famshëm • Midis një liste të gjatë kandidatësh të barabartë, të rekrutoni në mënyrë të rastësishme <p>Jeni anëtar i një paneli intervistesish për një rekrutim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të përpiqeni të bëni pyetje të thjeshta për t'u siguruar që edhe nëse kandidati nuk ia del, nuk do të jetë për shkakun tuaj, ju nuk doni të mbani peshën e refuzimit • Ju do të kërkoni të bëni pyetjet më të vështira të mundshme edhe përtej nevojave të pozicionit të punës vetëm për shkak se dëshironi të eliminoni dhe doni të ndjeni fuqinë tuaj mbi të tjerët • Do të përpiqeni të bëni pyetje shumë intime për shkak se doni të njihni më mirë kandidatët, edhe nëse shkoni përtej kufijve të jetës private, sepse mendoni se duhet të ndjeni personalitetin e vërtetë të rekrutuarve
<p>Shpjegoni zgjedhjet tuaja</p>	

Shtojca 3: modeli I bazuar tek kompetenca për Nivelin e Lartë Drejtues

MODELI I BAZUAR TEK KOMPETENCA PËR TND⁵

Autor: Z. Eric Roty
Ekspert afatshkurtër

Projekti i binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil shqiptar

⁵Raporti u përgatit nga Z. Eric ROTY – si pjesë e aktiviteteve të kryera në kuadrin e projektit të binjakëzimit Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil Shqiptar

PARATHËNIE

1. Matrica e kompetencave për anëtarët e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND) duhet të përmbushë dy kërkesat e mëposhtme:

- Të jetë në përputhje me të gjithë qasjen e re të paraqitur me Ligjin nr __, të marrë parasysh legjislacionin që rregullon krijimin e Trupës dhe përcaktimin e qëllimit të saj të përgjithshëm si dhe procedurat e rekrutimit dhe Menaxhimit
- Të konceptohet si një mjet praktik, i projektuar për të përmirësuar cilësinë e Trupës, kryesisht përmes një vëmendje më të madhe tek procedura e përzgjedhjes dhe kurrikula e trajnimit.⁶

2. Rregullat për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND) kanë këtë përbërje:

- Neni 27 deri 32 të ligjit nr° 152/2013 "Për nëpunësin civil", ndryshuar nga nenet 10 deri 14 të Ligjit nr. 178/2014
- VKM nr. 118 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së"
- Udhëzimi i DAP nr 6, datë 19.09.2014, për procesin e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë, anëtarë të TND

3. Në kuadrin e kompetencës, duhet të mbahen parasysh dy karakteristika shumë të rëndësishme nga ky kuadër ligjor, që do të thotë se Trupa është:

(i) e mbyllur, siç përcaktohet nga pozicionet e nëpunësve të saj. Kjo trupë përmbledh vetëm pozicionet më të larta në Zyrën e Kryeministrit (Sekretar i Përgjithshëm, Shef Departamenti, Drejtor i Përgjithshëm), në Ministri (Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor i Përgjithshëm) dhe në disa agjenci të varësisë (Drejtor i Përgjithshëm).

(ii) transversale, në kuptimin që anëtarët e TND-së nuk i bashkangjiten

një ministrie të caktuar, por kanë profilin për të zënë çdo pozicion të tillë të lartë në të gjithë administratën shtetërore (edhe pse jo në institucione të pavarura dhe njësi të qeverisjes vendore).

3. VKM-ja nr. 118 i përmendur më lart, në Kreun III pika 2, përcakton kuadrin e kompetencave për kandidatët e TND-së si më poshtë:

"Ky kuadër kompetencash konsiston në këto cilësi:

- a) Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme;
- b) Aftësi komunikimi;
- c) Aftësi të drejtimit strategjik;
- ç) Ndërtim i marrëdhënies ndërpersonale;
- d) Efektivitet;
- dh) Aftësi pune në grup;
- e) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;
- ë) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike;
- f) Besueshmëri;
- g) Vizion;
- gj) Të qenët krijues;
- h) Integritet;
- i) Njohuri për sistemin ligjor evropian."

Kjo listë, duke qenë pjesë e vendimit në fuqi, natyrisht do të merrret si bazë për zhvillimin e një kuadri të plotë.

⁶Kuadri i kompetencave mund të kontribuojë në të ardhmen edhe në një politikë të menaxhimit të Trupës (vlerësim më i mirë i performancës, emërimet më të informuara për pozicionet, zhvillim i karrierës të ngritur mbi kompetenca).

1. PREZANTIM I PËRGJITHSHËM

1.1 Arkitektura e kuadrit të kompetencave

Kompetenca është rezultat i një sërë aftësish, sjelljesh dhe pjesësh të dijeve (kompetencave) të cilat mund të vihen në punë për të vepruar në mënyrën e duhur dhe efikase në një situatë të caktuar profesionale.

Aftësia është zotësia e mësuar për të kryer një detyrë të caktuar. Ajo mbulon atë që dikush mund të bëjë (know-how) dhe fitohet kryesisht përmes përvojës praktike, megjithëse zotësia për të fituar aftësi specifike mund të rritet nga tiparet e lindura të personalitetit (p.sh. një personalitet i hapur për aftësitë e komunikimit) ndihmuar kjo edhe nga baza e njohurive teorike. Aftësitë mund të vlerësohen me testimet përkatëse.

Sjellja është mënyra në të cilën dikush vepron ose sillet, veçanërisht ndaj të tjerëve. Modelet e sjelljes janë të lidhura fort me karakterin ose personalitetin e një personi. Modelet e sjelljes dhe tiparet e karakterit janë të rëndësishme dhe të dobishme. Në situata profesionale mund të vlerësohet (pak a shumë) përmes testimit psikologjik të avancuar. Në kontekstin e procedurave normale të rekrutimit, të dhënat e kandidatit dhe intuita e intervistuesve me përvojë mund të japin një ide të përafërt të arsyeshme. Ndërkohë që prirjet natyrore si krijimtaria ose integriteti nuk mund të mësohen, disa studiues konsiderojnë se ato mund të përforcohen me trajnimet e duhura.

Njohuritë mbulojnë të gjithë informacionin dhe të kuptuarit, qofshin këto teknike apo teorike, që mund të arrihen përmes trajnimit, përvojës profesionale dhe asaj jashtë profesionit. Njohuritë mund të mësohen dhe vlerësohen lehtësisht.

Lista e kompetencave të TND-së e parashikuar në VKM nr. 118 mund të riorganizohet si më poshtë për të rigrupuar llojet e ndryshme të kompetencave të përcaktuara më lart:

Aftësi	Sjellje/karakter	Njohuri
a) Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme; b) Aftësi komunikimi; c) Aftësi të drejtimit strategjik; ç) Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale; d) Efektivitet; dh) Aftësi pune në grup	f) Besueshmëri; g) Vizion; gj) Të qenët krijues; h) Integritet;	e) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale; ë) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike; i) Njohuri për sistemin ligjor evropian

Përveçse janë përcaktime ligjore, 13 kompetencat e përzgjedhura nga VKM krijojnë një bazë shumë të mirë për të zhvilluar një kuadër të plotë të kompetencave.

Kuadri përbëhet kryesisht nga të ashtuquajturat " makro-kompetenca" dhe barazpesha midis llojeve të ndryshme të kompetencave duket e drejtë.

Makro-kompetencat janë kompetenca të përcaktuara gjerësisht që janë të nevojshme për të përmbushur kërkesat e një lloji të caktuar pune dhe mund të analizohen si një grup kompetencash të fokusuar më ngushtësisht.

Ekspertët dhe studiuesit në përgjithësi pajtohen se që të jenë të përdorshme për qëllime praktike, makro-kompetencat e kërkuara për një lloj pune të caktuar duhet të mbeten brenda një numri të menaxhueshëm, maksimumi midis 10 dhe 15; pra numri i përcaktuar në VKM është i drejtë.

EkUILIBRI I PËRGJITHSHËM I LISTËS, E CILA PROPOZON MË SË SHUMTI AFTËSI (6), ME DISA TIPARE TË RËNDËSISHME TË KARAKTERIT DHE SJELLJES (4) DHE ME NJË THEKS MË TË KUFIZUAR TEK NJOHURITË (3) PASQYRON NË PËRGJITHËSI NJË KONSSENSUS MBI ATË SE ÇFARË DUHET TË JETË OBJEKT I VËMENDJES NË PËRZGJEDHJEN DHE TRAJNIMIN E DREJTUESVE TË NIVELIT TË LARTË.

VKM ngre arkitekturën përkatëse të kuadrit të kompetencave, me kusht që secila prej tyre të detajohet në një grup përbërësish që lidhen më drejtpërdrejt me kërkesat e përzgjedhjes dhe trajnimit.

Kuadri i kompetencave do të paraqitet në formën e 13 skedave që detajojnë makro-kompetencat e renditura në VKM Nr. 118.

Çdo skedë do të përbëhet nga 4 pjesë

- Përkufizimi i makro-kompetencës
- Ndarja e makro-kompetencave në kompetenca elementare më të përshtatshme për të marrë vendime rekrutimi dhe trajnimi të informuara
- Një diskutim i shkurtër për mjetet e përzgjedhjes në dispozicion, për të identifikuar dhe nëse është e mundur për të vlerësuar kompetencën
- Një diskutim i shkurtër për metodat e trajnimit për të transmetuar ose përforcuar kompetencën

1.2. Njohuritë, aftësitë menaxhuese dhe drejtuese

Njohuritë

Nuk duhet të jetë një surprizë që, kur merresh me nivelet më të larta të Shërbimit Civil, kompetencat e bazuara në njohuri nuk janë një objekt i madh vëmendjeje.

Në atë nivel, kandidatët kanë fituar të gjitha njohuritë e dëshirueshme teorike dhe praktike përmes trajnimit universitar dhe përvojës së mëparshme profesionale.

Prandaj, VKM ka të drejtë të përqëndrohet vetëm në llojet e njohurive që janë më të nevojshme në pozicionet e nivelit të lartë.

Së pari, niveli i njohurive nuk përfshin informacionin, por një kuptim

të thellë se si funksionon administrata në lidhje me mjedisin e saj (fenomenet ekonomike dhe sociale) dhe duke qenë se funksionon si një sistem i ndërlidhur (kompetenca ndërsektoriale).

Elementi i tretë i bazuar në njohuri (e drejta dhe institucionet evropiane) është një domosdoshmëri, duke pasur parasysh kontekstin e negociatave dhe anëtarësimin e ardhshëm në BE dhe faktin se shumica e anëtarëve dhe kandidatëve të TND-së ndoshta nuk e njohin plotësisht.

Shpresojmë që vendi i kufizuar i dhënë njohurive ndërmjet kompetencave të kërkuara do të frenojë prirjen për t'i dhënë peshë të tepruar këtij përbërësi në testimet me shkrim dhe madje edhe në intervista.

Ky është një paragjykim natyror për shkak të faktit se njohuria është shumë më e thjeshtë për t'u matur objektivisht sesa aftësitë ose sjelljet. Është argumentuar gjithashtu se anëtarët e Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes janë akademikë në shumicën e tyre dhe si të tillë nuk kanë domosdoshmërisht përvojë të madhe në punën aktuale në organizatat qeveritare. Si rezultat, ata mund të kenë qenë akoma më të prirur të mbështeten me tepri në pyetjet e bazuara në njohuri, si në testimin me shkrim ashtu dhe në intervista, në vend që të përpiqen të vlerësojnë aftësitë dhe të çmojnë karakterin e kandidatëve.

Aftësitë menaxhuese

I gjithë koncepti i TND-së bazohet në hamendësimin se pozicionet e larta të menaxhimit janë paksa të ndryshme në thelb nga pozicionet e tjera në organizatat dhe kërkojnë lloje të tjera aftësish dhe cilësish. Në të kundërt me personelin e nivelit më të ulët, drejtuesit duhet të motivojnë të tjerët në vend që të bëjnë punë vetë, duhet të përqëndrohen në të menduarit afatgjatë & strategjik dhe jo në drejtimin e veprimeve të përditshme, prandaj kërkojnë kryesisht "aftësi drejtuese" në krahasim me aftësi shumë të zhvilluara teknike ose të specializuara.

Kjo është linja e arsyetimit që justifikon ekzistencën e një Trupe të veçantë anëtarët e të cilës , të paktën në teori, janë të aftë të mbulojnë çfarëdo pozicioni të lartë drejtues në organizatë.

Prandaj, aftësitë e kërkuara nga drejtuesit e lartë të gjitha janë "aftësi drejtimi" të pastra, me pak kërkesa për njohuri - siç u diskutua më sipër dhe pa aftësi profesionale teknike ose specifike.

Nga katër kompetencat e sjelljes në listë, dy prej tyre, konkretisht besueshmëria dhe integriteti janë ato që duhet të priten nga çdo nëpunës civil, por janë veçanërisht të rëndësishme për drejtuesit e lartë, të cilët mund të vendosin me shembullin e tyre tonin për një organizatë të tërë, ndërsa dy të tjerat, vizioni dhe të qenët krijues, janë kërkesa me të vërtetë specifike të pozicioneve të larta drejtuese.

Shkurt, rezultati i proceseve të rekrutimit dhe trajnimit duhet të sigurojë dhe në njëfarë mënyrë të garantojë që anëtarët e TND-së të kenë cilësitë dhe aftësitë drejtuese të kërkuara për të zënë pozicione të nivelit të lartë, me kusht që ato të jenë të bazuara në kuadrin e kompetencave dhe që kuadri i kompetencave të jetë konceptuar mirë.

Megjithatë, "menaxhimi i pastër" si një gje e pavarur nga përmbajtja aktuale e misionit, kulturës dhe njohurive teknike të një organizate nuk ekziston.

Në të vërtetë, aftësitë e menaxhimit nuk janë faktori i vetëm për të përcaktuar suksesin e një drejtuesi të lartë: mënyra se si ai / ajo përshtatet me organizatën (përvoja profesionale në terren, besueshmëria teknike, rrjeti profesional) gjithashtu luan një rol pak a shumë të rëndësishëm. Në rastin e ministrive shqiptare, ky element profesional është ndoshta më pak i rëndësishëm në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, dhe më shumë në rastin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Këtu nuk mohohet rëndësia e aftësive drejtuese apo vlefshmëria e konceptit të TND-së, por duhet theksuar se DAP do të duhet të zhvillojë një politikë të strukturuar për emërimin e drejtuesve të lartë, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, përfshirë historikun dhe ecurinë profesionale të anëtarëve të TND-së.

Leadership

Mund të duket e çuditshme që modeli i kompetencave i zhvilluar për drejtuesit e lartë injoron tërësisht konceptin e "udhëheqjes-leadership", i cili nuk shfaqet në listën e makro-kompetencave të përcaktuara nga VKM Nr. 118.

Në fakt, duke studiuar përshkrimin e mëposhtëm (të shkëlqyer) të karakteristikave të udhëheqësit tipik, huazuar nga modeli i kompetencave kanadeze për drejtuesit e lartë, është e lehtë të njihet imazhi i njëjtë i udhëheqësit në listën tonë, me të njëjtat cilësi: vizioni dhe strategjia, aftësitë e punës në ekip, efektiviteti, integriteti, kreativiteti.

- Krijojnë vizion dhe strategji: Udhëheqësit përcaktojnë të ardhmen dhe ravijëzojnë rrugën përpara. Ata janë të aftë të kuptojnë dhe komunikojnë kontekstin, të faktorizohen në mjedisin ekonomik, social dhe politik. Intelektualisht të shkathët, ata përdorin njohuritë e tyre të thella dhe të gjera, ndërtojnë mbi idetë dhe perspektivat e ndryshme dhe krijojnë konsensus rreth vizione bindëse.
- Mobilizojnë njerëzit: Udhëheqësit frymëzojnë dhe motivojnë njerëzit që udhëheqin. Ata administrojnë performancën, japin reagime konstruktive dhe të respektueshme për të inkurajuar dhe për të arritur përsosmërinë e performancës. Ata udhëheqin me shembull, duke përcaktuar qëllimet për veten të cilat janë më kërkuese sesa ato që u kanë caktuar të tjerëve.

- Mbështesin integritetin dhe respektin: Udhëheqësit pasqyrojnë ushtrimin e etikës, profesionalizmin dhe integritetin personal. Ata krijojnë ambiente pune të respektueshme dhe të besueshme, ku vlerësohen këshillat e shëndosha. Ata inkurajojnë shprehjen e mendimeve dhe perspektivave të ndryshme, duke nxitur kolegjalitetin. Udhëheqësit janë të vetëdijshëm dhe kërkojnë mundësi për rritje personale.
- Bashkëpunojnë me partnerët dhe palët e interesuara: Udhëheqësit janë të matur dhe të mendjemprehtë kur kërkojnë spektrin më të gjerë të mundshëm të perspektivave. Ata tregojnë hapje dhe fleksibilitet për të krijuar konsensus dhe për të përmirësuar rezultatet. Ata sjellin perspektivën e tërë të qeverisë në ndërveprimet e tyre. Kur negociojnë zgjidhje, ata janë të hapur për alternativa dhe të aftë në menaxhimin e pritshmërive. Udhëheqësit ndajnë meritat me ekipet dhe partnerët e tyre.
- Nxisin risitë, drejtojnë ndryshimet: Udhëheqësit kanë guximin dhe elasticitetin për të sfiduar traditat. Ata krijojnë një ambient që mbështet mendimin e guximshëm, eksperimentimin dhe marrjen përsipër të rrezikut inteligjent. Ata përdorin pengesat si burim të vlefshëm për të kuptuar dhe për të mësuar. Udhëheqësit bëjnë ndryshime me hapa të mëdha, duke bashkërenduar dhe përshtatur piketat dhe objektivat për të mbajtur ecjen përpara.
- Arrijnë rezultate: Udhëheqësit mobilizojnë dhe administrojnë burimet për të zbatuar prioritetet e Qeverisë, për të përmirësuar rezultatet dhe për të shtuar vlerat. Ata e marrin parasysh kontekstin, rreziqet dhe inteligjencën e biznesit për të mbështetur vendime me cilësi dhe në afat. Ata parashikojnë, planifikojnë, mbikëqyrin progresin dhe përshtaten sipas nevojës. Udhëheqësit marrin përgjegjësi personale për veprimet dhe rezultatet e vendimeve të tyre.

2.KUADRI I KOMPETENCAVE PËR TND-në:

13 SKEDA

SKEDA 1 - Aftësia për të drejtuar dhe menaxhuar veprime të ndryshme Aftësi drejtimi

Përkufizimi

Aftësia për të drejtuar dhe administruar veprime të ndryshme është përbajtja kryesore e një pune drejtuese.

- "Drejtimi dhe Menaxhimi" i referohet aftësisë për të planifikuar dhe organizuar detyrat si dhe për njerëzit që duhet t'i kryejnë.
 - "Veprime të ndryshme" janë më specifike për drejtuesit e lartë, të cilët duhet të ndjekin të gjitha veprimet brenda organizatës së tyre.
- Prandaj, përbërësit do të mbulojnë më së shumti aftësitë e drejtimt klasik, veçanërisht në fushat e drejtimt të projekteve dhe programeve, vendimmarrjes, drejtimt të ekipit dhe efikasitetit personal.

Përbërësit dhe mjetet

1. Planifikimi dhe drejtimi, mbikëqyrja e zbatimit dhe rezultatet
2. Drejtimi i ekipit, duke ditur se si delegohen dhe motivohen bashkëpunëtorët dhe krijuar komunikim të brendshëm efikas
3. Aftësi të larta pune dhe aftësi organizative (të mos humbasësh kohë me detaje të panevojshme; të jesh në gjendje të përcaktosh urgjencat në projekte në një mënyrë kuptimplote dhe praktike; aftësi për të organizuar dhe programuar njerëzit dhe detyrat.
4. Mjetet e zhvillimit personal: Menaxhimi i kohës dhe stresit, organizimi efikas i mbledhjeve

Përgjegdhja / rekrutimi

Studimi i përvojës profesionale të kandidatëve dhe historikut të tyre do të ofrojë bazën më të mirë për të vlerësuar shumicën e kompetencave të kërkuara. Njohja me teknikat e planifikimit dhe Menaxhimit mund të kontrollohet me pyetje me shkrim dhe me gojë. Ekzistojnë "testime mbi situata të jetës reale" për të vlerësuar aftësitë e drejtimt të ekipit.

Trajnimi

Ekzistojnë kurse dhe ushtrime specifike për të trajnuar drejtuesit për shumicën e aftësive drejtuese të përfshira në këtë kompetencë.

SKEDA 2 – Aftësitë e komunikimit Aftësi drejtimi

Definition

Komunikimi është aftësia për të përcjellë informacionin dhe idetë në mënyrë efektive dhe bindëse. Të jesh një komunikues i mirë është një domosdoshmëri për drejtuesit e lartë të sotëm, të cilët jo vetëm që duhet të marrin vendime por edhe të mobilizojnë (nga brenda) dhe të bindin (nga jashtë). Ata duhet të mësojnë kanalet klasike të komunikimit me gojë dhe me shkrim (duke mos harruar se të dish të dëgjosh është një pjesë e rëndësishme e tij), plus raste të veçanta që janë më specifike për pozicionet e drejtuesve të lartë.

Përbërësit dhe mjetet

1. Komunikimi verbal: të jesh në gjendje të dëgjosh në mënyrë efektive; të bësh prezantime verbale të qarta dhe bindëse; të sqarosh informacionin sipas nevojës.
2. Komunikimi me shkrim: të shkruarit në mënyrë të qartë, konciz, të organizuar dhe bindës; të jesh në gjendje të përshtatesh me publikun e prishëm (vendimmarrësit politikë, personelin, publikun e gjerë).
3. Format specifike të komunikimit: të flasësh në media; komunikimi në rast krize; moderimi i ngjarjeve publike.
4. Të dish se si organizohet dhe kontrollohet komunikimi i organizatës; të krijosh rregulla dhe procedura për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Përzgjedhja/rekrutimi

Aftësitë e komunikimit me shkrim mund të vlerësohen lehtësisht me kusht që pjesa me shkrim e konkursit të përfshijë të paktën një nga ushtrimet e mëposhtme: shkrimi i një një eseje, shkrimi i një memoje, përmbledhja e një dosjeje të përbërë nga dokumente të ndryshme në një situatë profesionale. Aftësitë e komunikimit me gojë mund të vlerësohen mjaft mirë nga intervistuesit me përvojë (për shembull kandidatit duhet t'i jepet disa minuta pa ndërprerje për të argumentuar një qëndrim).

Trajnimi

Metodat klasike për të përmirësuar aftësitë e komunikimit me shkrim dhe me gojë janë të mirënjohura. Në mënyrë ideale, pjesë e kurrikulës duhet të jenë trajnimi për mediat dhe një kurs për komunikimin institucional.

SKEDA 3. Aftësitë e drejtimit strategjik Aftësi drejtimi

Përkufizimi

Drejtimi strategjik lidhet me faktin se drejtuesi i lartë duhet të shikojë përtej ecurisë së aktiviteteve ditore për të parë misionin dhe strukturën e organizatës së tij në një perspektivë afatgjatë. Baza e drejtimit strategjik është aftësia për të menduar të ardhmen, duke marrë parasysh faktorët e ndryshëm që do të formësojnë evolucionin e organizatës, për të vepruar sipas kësaj prishmërie. Prandaj ky drejtim përfshin formulimin dhe zbatimin e qëllimeve dhe nismave kryesore që duhet të ndërmerren në emër të shërbimit publik dhe interesit të përgjithshëm, bazuar në burimet dhe në vlerësimin e mjediseve të brendshme dhe të jashtme në të cilat vepron organizata.

Përbërësit dhe mjetet

1. Mendimi strategjik: të mendosh në afate të gjata, të jesh në gjendje të sintetizosh të gjitha llojet e informacionit në lidhje me mjedisin dhe prirjet (politike, ndërkombëtare, ekonomike, sociale, teknologjike, ligjore) në të cilat organizata vepron, pastaj të marrësh një seri vendimesh strategjike rreth mënyrës se si duhet të zhvillohet organizata.
2. Planifikimi strategjik: formulimi i objektivave dhe prioritetëve që duhet të ndjekë organizata dhe zbatimin e planeve në përputhje me interesin afatgjatë të organizatës në një mjedis global; duke ditur se si të përfitosh nga mundësitë dhe nga Menaxhimi i Rrezikut.
3. Ndërgjegjësimi i jashtëm: të kuptosh dhe të përditësohesh mbi politikën dhe prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare që ndikojnë tek organizata dhe formojnë pikëpamjet e palëve të interesuara; të jesh i vetëdijshëm për ndikimin e organizatës në mjedisin e jashtëm.

Përzgjedhja/rekrutimi

Qasja më e mirë mund të jetë të testohen orientimi i kandidatit drejt të ardhmes dhe interesat për prirjet kryesore në fusha të ndryshme (teknologji, integrimi evropian, kultura e internetit, menaxhimi i burimeve njerëzore...)

Trajnimi

Rastet studimore dhe planifikimi i skenarit janë mjete të mira për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e të menduarit dhe planifikimit strategjik. Mund të përfshihen në kurrikula edhe metodat e formalizuara si SWOT dhe PEST.

FICHE 4. Ndërtimi i marrëdhënieve ndërpersonale Aftësi drejtimi

Përkufizimi

